

VENDIM
Nr.26, datë 29.3.2010

MBI KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES HEC I TERVOLIT TË SHOQËRISË
“HEC I TERVOLIT” SHPK, SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “l”, nenit 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 9 pikat 1 dhe 2 germa “a” të “Rregullores për procedurat e certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.3.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC i Tervolit” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi kualifikimin e impiantit prodhues HEC i Tervolit të shoqërisë “HEC i Tervolit” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e impiantit prodhues HEC i Tervolit të shoqërisë “HEC i Tervolit” sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta